

Izet Zeqiri, PhD

**PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE EKONOMIA E SHQIPTARËVE 112
VJET PAS - ANALIZË KRAHASUESE SHQIPËRI, KOSOVË,
MAQEDONIA E VERIUT**

**НЕЗАВИСНОСТА НА АЛБАНИЈА И ЕКОНОМИЈАТА НА
АЛБАНЦИТЕ 112 ГОДИНИ ПОДОЦНА – КОМПАРАТИВНА
АНАЛИЗА: АЛБАНИЈА, КОСОВО, СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**THE INDEPENDENCE OF ALBANIA AND THE ECONOMY OF
ALBANIANS 112 YEARS LATER – A COMPARATIVE ANALYSIS:
ALBANIA, KOSOVO, NORTH MACEDONIA**

Abstract

Ky punim ka për qëllim të ofrojë një analizë të situatës ekonomike të shqiptarëve pas pavarësisë së Shqipërisë në analizë të përfshihet situatë ekonomike e Shqipërisë 112 pas pavarësisë, situatës ekonomike të Maqedonisë së Veriut dhe situatës ekonomike të Kosovës si dy vende të ish-Jugosllavisë dhe periudhës pas pavarësisë. Gjithashtu do të bëhet një krahasuese të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar ndikimet që ka pasur Pavarësia e Shqipërisë në vitin 1912 në zhvillimin ekonomik të shqiptarëve në këto tri shtete. 112 ekonomike vjet pas shpalljes së Pavarësisë, ky studim fokusohet në ndikimin e faktorëve historikë, politikë dhe ekonomikë në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë. Punimi shqyrton zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi dhe asaj shqiptare në veçanti, ndryshimet që kanë ndodhur pas periudhave të ndryshme historike, dhe përpjekjet për të zhvilluar një ekonomi stabile dhe të qëndrueshme. Për këtë qëllim, përdorim metoda të ndryshme kërkimore për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, duke u mbështetur në literaturën ekzistuese dhe burimeve të besueshme.

Fjalë kyçe: Pavarësia, Ekonomia e Shqipërisë, Shqipëri, Kosovë, Maqedonia e Veriut, Krahasim Ekonomik, Zhvillimi Ekonomik.

Hyrje

Pavarësia e Shqipërisë në vitin 1912 shënoi një moment të rëndësishëm në historinë e kombit shqiptar, duke hapur një periudhë të re të zhvillimit politik dhe ekonomik. Megjithatë, ndikimi i Pavarësisë së Shqipërisë në ekonominë e shqiptarëve ka qenë i ndryshëm në varësi të kushteve historike dhe politike të çdo shteti. Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova, edhe pse ndajnë një lidhje të fortë historike dhe kulturore, kanë kaluar periudha të ndryshme zhvillimi ekonomik, duke u përballur me sfida dhe mundësi të ndryshme. Pas 112 vjetësh, ky studim synon të bëjë një analizë krahasuese të zhvillimit ekonomik të këtyre tre shteteve, duke shqyrtuar ndikimet e ndryshimeve politike, transformimeve sociale dhe ekonomike të këtyre vendeve si dhe duke analizuar përparimin ekonomik dhe sfidat kryesore të këtyre vendeve në rrugën e integritimit në Unionin Evropian.

Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi do të përdorë një qasje krahasuese dhe një metodologji të kombinuar, duke përfshirë metodat kualitative dhe kuantitative për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Do të mbledhen të dhëna nga burime të besueshme dhe të publikuara nga institucionet e ndryshme, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Eurostat dhe institucionet shtetërore të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Do të përdoret Analiza Krahasuese ku do të bëhet krahasimi i zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut pas Pavarësisë, duke përdorur analizën e trendëve të zhvillimit ekonomik, politikave ekonomike dhe pasojave të ndryshme që kanë ndodhur gjatë periudhave të ndryshme historike.

1. Ekonomia e Shqipërisë dhe zhvillimi i saj në periudha kohore të ndryshme

Shqipëria shpalli Pavarësinë më 28 nëntor 1912 dhe ka kaluar përmes periudhave të ndryshme ekonomike nga ajo kohë deri sot. Pas periudhës së dominimit osman dhe luftërave të pasluftës së Dytë Botërore, ekonomia e Shqipërisë ka kaluar nëpër faza të ndryshme duke përfshirë periudhën e komunizmit, fazën e tranzicionit pas 1991 dhe periudhën moderne të rritjes ekonomike dhe stabilizimit.

Pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 1912, ekonomia e Shqipërisë ishte shumë e dobët dhe e varfër. Bujqësia ishte sektori më i rëndësishëm, duke përbërë rreth 80% të ekonomisë. Industria dhe sektorë të tjerë mbetën të pazhvilluar për shkak të kushteve të vështira dhe të pasigurisë politike. Shqipëria pas Pavarësisë ishte një vend që mbështetej kryesisht në bujqësinë dhe kishte një strukturë ekonomike të dobët, që kërkonte një zhvillim të ngadalshëm. Pas pavarësisë në vitin 1922, numri i ndërmarreve industriale arriti në 85, nga 34 që ishin në vitin 1912. Bujqësia, ku ishin punësuar mbi 87% e fuqisë së aftë për punë, ishte sektori kryesor i ekonomisë dhe kontribuonte me 92.4% në formimin e të ardhurave kombëtare, ndërkohë që vetëm 10.2% e tokave kultivoheshin rregullisht dhe prodhimet kryesore ishin gruri, misri e thekra. Toka punohej me mjete primitive, niveli i rendimenteve dhe shkalla e mekanizimit të bujqësisë ishin shumë të ulta. (*Akademia, e Shkencave e Shqipërisë* (2007). Në vitin 1946, Shqipëria kaloi në një sistem komunist. Regjimi komunist ka ndikuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, duke u mbështetur kryesisht në planifikimin centralizuar dhe në një sistem të mbyllur ekonomik. Gjatë regjimit komunist, Shqipëria bëri përpjekje për të industrializuar ekonominë dhe për të zhvilluar sektorë të tjerë si energjia dhe infrastruktura, por me kufizime të mëdha në teknologji dhe kapital. Gjatë kësaj periudhe, ekonomia shqiptare u mbajt e centralizuar dhe u zhvillua një industri e varfër, ndërkohë që vendi ishte mbyllur për tregjet ndërkombëtare dhe për investimet e huaja.

Në vitin 1945-1946, shteti shqiptar shpalli platformën bazë të bujqësisë bazuar në kolektivizimin e prodhuesve të vegjël dhe krijimin e fermave të mëdha shtetërore. Shkatërruese për sistemin agraro-ushqimor ishte direktiva e vitit 1966 kurrë filloi aksioni tu qepemi kodrave e maleve dhe ti bëjmë pjellore si fushat që vendi të siguroj bukën në vend me forcat tona. Rezultati i kësaj nisme ishte katastrofik, jo vetëm për rezultatet shumë të vogla në prodhimin e grurit dhe misrit.

Ekonomia shqiptare gjatë regjimit komunist (1945-1990) karakterizohet me kolektivizimin integral të bujqësisë ku 78.80% dominonin kooperativat, 20.70% firmat shtetërore, 3.50% kopshtet individuale. Ekonomia gjatë regjimit komunist ka qenë tërësisht e varur nga ndihmat e huaja Gjatë viteve 1955-1960 ndihma e huaj ishte sa 233% e buxhetit ndërsa gjatë viteve 1960-1965 ndihma e huaj sa 130% e buxhetit. (<https://euronews.al/ekonomia>). Në tabelë janë paraqitur ndihmat sipas viteve të vendeve si Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik dhe Republikës së Kinës.

	1948	1949	1960	1960-1978
Jugosllavia	Kredi dhe grante sa gjysma e buxhetit të Shqipërisë			
Bashkimi Sovjetik		38% e të ardhurave Kredi dhe grante të	1 miliardë rubla, afërsisht 250 milionë dollar = 2,7 miliard \$	
Republika e Kinës			Ndihma ekonomike financiare	Rreth 5 miliardë dollarë ndihma ekon. dhe financiare

Periudha e Tranzicionit (1991-2000) pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria kaloi në një periudhë të tranzicionit dhe kaloi nga një ekonomi planifikuese në një ekonomi tregu. Kjo periudhë shënoi fillimin e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe liberalizimin e tregut. Sipas Bankës Qendrore të Shqipërisë (2021), “Shqipëria, pas 1991, iu nënshtrua një sërë reformash strukturore që synonin të hapnin ekonominë dhe të krijonin një ambient të favorshëm për investimet e huaja.”

Një nga ngjarjet më shkatërruese gjatë kësaj periudhe ishte kriza e piramidave financiare të vitit 1997, që shkaktoi një kolaps të sistemit bankar dhe ndikoi rëndë në besimin e publikut në institucionet financiare. Kjo krizë solli një rënie dramatike të ekonomisë dhe shpërthimin e dhunës shoqërore.

Nga fillimi i viteve 2000, Shqipëria ka kaluar në një periudhë të rritjes ekonomike të qëndrueshme. Ndihmuar nga politikat e liberalizimit dhe privatizimit, ekonomia shqiptare ka arritur të rritet mesatarisht me 5% në vit deri në vitin 2008. Raporti i Komisionit Evropian (2022) thekson se, “Shqipëria gjatë kësaj periudhe ka parë rritje të investimeve të huaja dhe ka filluar të diversifikojë sektorët ekonomikë si energjia dhe turizmi.” Në këtë periudhë u realizuan shumë reforma dhe investime të rëndësishme në infrastrukturë, duke përfshirë projekte rrugore dhe energjetike. Shqipëria u përballë me krizën financiare globale të vitit 2008, që ndikoi në rënien e investimeve dhe zhvillimin e ekonomisë. “Krizat financiare dhe pasiguritë globale kanë vonuar procesin e transformimit ekonomik dhe kanë shtuar sfidat për qeverinë

shqiptare, e cila u detyrua të rrisë borxhin publik për të mbështetur rritjen” (Shqipëria në Tranzicion: Raporti i Bankës Botërore, 2020).

Për periudhën pas 2015, Shqipëria ka pasur një rritje të qëndrueshme të PBB-së dhe ka bërë përparime në sektorët si turizmi, energjia dhe bujqësia. Sipas një raporti të Fondit Monetar Ndërkombëtar (2023), “Shqipëria ka pasur një rritje mesatare të PBB-së prej 4% në vit, falë rritjes së turizmit dhe rritjes së investimeve të huaja.

Ajo çka është e rëndësishme të theksohet se Shqipëria është përballur me një emigrim masiv nga viti 1990. Një studim të emigracionit shqiptar në strukturë moshe dhe sipas destinacioneve kryesore, 1990-2019 tregon se diaspora e vlerësuar përllogaritet 1.684.135 individë jashtë territorit të Shqipërisë, ku 884.719 individë janë meshkuj dhe 799.416 janë femra. Ajo që është më shqetësuese është fakti i emigrimit familjar gjë që e tregon edhe raporti i migrimit sipas grupmoshave edhe atë: grupmosha (0-14 vjeç) është rreth 19 %; pjesën kryesore e zë grupmosha (15-64 vjeç), me rreth 76 % dhe ajo mbi 65 vjeç, afërsisht 5 %. (Diaspora e Shqipërisë në Shifra) Instat 2020.

Grup-mosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0-4	44.800	40.019	84.819
5-9	60.366	51.387	111.753
10-14	64.382	55.002	119.384
15-19	59.689	50.083	109.772
20-24	67.194	54.763	121.957
25-29	76.080	68.332	144.412
30-34	86.217	88.497	174.714
35-39	88.703	86.680	175.383
40-44	84.799	78.971	163.770
45-49	74.845	65.170	140.015
50-54	58.579	48.733	107.312
55-59	45.266	37.828	83.094
60-64	31.953	25.457	57.410
65-69	17.533	13.975	31.508
70-74	8.054	6.480	14.534
75-79	5.700	9.862	15.562
80-84	3.471	4.539	8.010
85+	7.088	13.638	20.726
Gjithsej	884.719	799.416	1.684.135

Në vitet e fundit, ekonomia e Shqipërisë ka filluar të rritet me një ritëm të qëndrueshëm, falë disa faktorëve si: turizmi, Shqipëria ka zhvilluar një sektor të rëndësishëm të turizmit, i cili ka kontribuar në rritjen e PBB-së dhe ka krijuar mundësi punësimi. (INSTAT, 2022), “Turizmi është një nga sektorët që ka pësuar rritjen më të shpejtë, me një rritje prej 10% në vitin 2021.”

Rritja reale e PBB analizuar nga viti 2013 ka shënuar një rritje simbolike në dy tre vitet e para, kështu që 2017 rritja ka qene 3,3%, 2018 rritja ka qene 3,8%, 2019 ka qene 4%, viti i kryerjes së pandemisë

ka pasur një rënie për t'u ngritur në 8,9% vitin 2022 dhe në vitin 2023 Shqipëria shënon rritje prej 4,9%.



financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Treguesit-Kryesorë-Makroekonomik-2023.pdf

2. Ekonomia e Maqedonisë - zhvillimi dhe sfidat e saj

Maqedonia e Veriut shpalli pavarësinë nga Jugosllavia më 8 shtator 1991 dhe ka kaluar një rrugë të vështirë për të arritur një ekonomi të qëndrueshme. Pas periudhës së Jugosllavisë, Maqedonia ka përjetuar sfida të mëdha ekonomike, duke kaluar nga një ekonomi planifikuese dhe centralizuar në një ekonomi të tregut. Maqedonia ishte e mbështetur kryesisht në bujqësi, por ndodhi një ngadalësim i industrisë dhe rritjes së investimeve. Sektorët si energjia dhe infrastruktura, që ishin njëherë të centralizuara në sistemin socialist, u përballën me një mungesë të burimeve dhe menaxhimit të duhur.

Tranzicioni dhe reformat ekonomike në Maqedoninë e Veriut nisën një proces të gjatë të privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe liberalizimit të tregut. Kjo periudhë përfshiu fillimin e privatizimit të industrive, rritjen e investimeve të huaja dhe fillimin e integritit të vendit në organizata ndërkombëtare.

Me ligjin e privatizimit ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme të krijuara me djersën e të gjithë qytetarve u transformuan në shoqata akcionare sipas shumë mënyrave të cilat ndërmarrjet e kanë zgjedhur së bashku me agjencionin për transformimin e kapitalit shoqëror. Shqiptarët, privatizimin dhe transformimin e kapitalit shoqëror e konsiderojnë si një proces të ndërlikuar ekonomiko-social dhe politik dhe diskriminues, ku në kushtet e pronësisë shoqërore secili shqiptar kishte të drejtë të pronësisë në pjesën e përcaktuar ideale të mjeteve shoqërore.

Privatizimi dhe pasojat e procesit të privatizimit

Një nga ndryshimet më të rëndësishme që sollën deri te krijimi i strukturës së re pronësore është procesi i filluar i transformimit në mbarim të 1998 dhe me dispozitat ligjore të 1989/90, me të cilat filloi shndërrimi i pronës shoqërore në forma të tjera të pronësisë. Ky proces filloi qysh me reformat e vitit 1989, i cili vazhdoi me ligjin për transformimin e kapitalit shoqëror në vitin 1993, ku u krijua mundësia që ndërmarrjet shoqërisë të transformohen në forma të ndryshme të ndërmarrjeve të përziera, në raste të shpeshta edhe si shoqatat aksionare që emitojnë aksione interne të cilat mund t'i blinin vetëm punëtorët e punësuar në ato ndërmarrje, madje me zbritje të konsideruar. Një nga parimet themelore të privatizimit të kapitalit shoqëror ishte shitja e kapitalit shoqëror ku ndërmarrjet organizohen si shoqata aksionare dhe shoqata me përgjegjësi të kufizuar me pronar të përcaktuar privat. (Realitete ekonomike 2005)

Si një nga mënyrat më të preferuar e privatizimit ka qenë edhe shitja e ndërmarrjeve menaxherike e cila mënyrë ka qenë një diskriminim për shqiptarët, sepse kjo mënyrë ka paraqitur një barrierë të vërtetë që edhe shqiptarët të inkuadrohen në procesin e privatizimit, pasi dihet fakti se në asnjë ndërmarrje shoqërore nuk ka pasur menaxher shqiptar që aktivisht do të kyçej në procesin e privatizimit.

Shqiptarët, privatizimin, transformimin e kapitalit shoqëror e konsiderojnë si një proces të ndërlikuar ekonomiko-social dhe politik, pasi në këtë proces u ndryshuan marrëdhëniet themelore të prodhimit u ndryshua kuptimi i deritashëm i pronësisë shoqërore, u rëndua POZITA EKONOMIKE DHE SOCIALE E SHQIPTARËVE, pasi në kushtet e pronësisë shoqërore secili shqiptar kishte të drejtë të pronësisë në pjesën e përcaktuar ideale të paramenduar të mjeteve shoqërore (siç quhej në punën e bashkuar).

Numri i ndërmarrjeve të privatizuara sipas madhësisë		
Madhësia		Vlera (DM)
Të mëdha	263	3.159.782.509
Të mesme	327	912.705.597
Të vogla	1072	439.416.692
Gjithsej	1662	4.511.904.797

Numri i ndërmarrjeve të privatizuara në bazë të modeleve të privatizimit

Modeli	Ndërmarrje	Të punësuar	Vlera (DM)
Ligji i vjetër	66	11.522	114.471.007
Grumbullim nga të punësuarit	395	17.216	155.744.498
Pjesa ideale	180	26.799	617.065.820
Marrja e udhëheqjes	239	71.667	1.386.075.043
Qiraja	4	217	18.572.951
Kapitali plotësues	27	7.62	171.472.828
Bartja e Agjencisë	28	14.717	305.292.394
Konverzioni	89	20.497	595.939.170
Kapitali i huaj	155	1.843	49.400.052
Kapitali privat	138	4.817	67.280.369
Likuidimi	168	1.016	113.709
Blerje	173	50.339	1.045.414.213
Gjithsej	1662	228.27	4.511.904.797

Pas vitit 1990 sektori i shërbimeve, përfshirë bankat dhe tregtinë, mori një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit, duke përmirësuar sektorin e brendshëm të konsumit dhe eksportet.


Republika e Maqedonisë ka ndërtuar një stabilitet të jashtëzakonshëm makroekonomik gjatë viteve të fundit. Rritja e PBB-së u rrit në 5.9% në 2007 dhe 4.8% në 2008, si rezultat i kërkesës më të lartë në tregun e brendshëm dhe rritjes së investimeve. (STRATEGJIA ZA REPUBLIKA MAKEDONIJA 2010-2013)

Në vitin 2008, Maqedonia, si shumicën e shteteve të tjera, u ndikua nga kriza financiare globale. Ekonomia e vendit e përjetoi një ngadalësim të konsiderueshëm, ndërsa investimet e huaja u ulën dhe eksportet ranë. Nga vitet 2015 e tutje, Maqedonia ka pasur një rritje të qëndrueshme ekonomike. Investimet e huaja, veçanërisht në sektorin e energjisë dhe infrastrukturës, kanë kontribuar në zhvillimin e vendit. Sipas një raportit të Bankës Qendrore të Maqedonisë (2020), “Maqedonia ka parë një rritje të qëndrueshme të PBB-së në vitet e fundit, duke shënuar një rritje mesatare prej 3-4% në vit.”


Pas vitit 2015, Maqedonia ka pasur një periudhë të qëndrueshme rritjeje ekonomike. PBB-ja e Maqedonisë ka rritur mesatarisht me 3-4% në vit. Sektori i industrisë, ndërtimit dhe turizmit ka kontribuar në

rritjen e përgjithshme të PBB-së, ndërsa sektorët e tjerë si energjia dhe shërbimet janë gjithashtu zgjeruar.

Bruto prodhimi i brendshëm PBB dhe PBB për capital 2008-2023 është paraqitur në tabelën që vijon:



Sfida e Maqedonisë së veriut është borxhi publik si një tregues i rëndësishëm ekonomik që reflekton shkallën e borxhit që një shtet ka ndaj kreditorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në rastin e Maqedonisë së Veriut, borxhi publik ka kaluar nëpër periudha të ndryshme zhvillimi, me rritje dhe ulje, duke reflektuar sfidat ekonomike, politikat fiskale dhe nevojat për financim. Gjatë periudhës 2002-2024, borxhi publik i Maqedonisë ka evoluar për shkak të faktorëve të brendshëm dhe ndërkombëtarë, duke pasqyruar situatën ekonomike dhe borxhit të jashtëm.



Pavarësisht rëndësisë së zhvillimit rajonal të barabartë, ka disa sfida që pengojnë arritjen e këtij qëllimi në Maqedoninë e Veriut: Pabarazitë ekonomike dhe sociale, mungesa e infrastrukturës: Qasja e kufizuar në shërbimet publike dhe arsimi, migrimi i brendshëm.

Ekonomia e Maqedonisë përballet me pabarazi të theksuara ndërmjet rajoneve, me disa zona që kanë nivele më të ulëta të zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve sikur në tabelë.

Shkupi është tash më qendër administrative-politike me mundësi të pakufizuara të zhvillimit dhe me centralizim politik dhe ekonomik e cila tregohet me hipertrofi dhe aglomerim të resurseve. Kjo mundësuar që të kemi zhvillim regjional monocentrik me dominim të qytetit të Shkupit në zhvillimin ekonomik në Maqedoni. Në Shkup janë të koncentruar mbi 30% e popullsisë dhe mbi 50% e popullsisë urbane, në Shkup rrjedhë procesi i koncentrimit të resurseve financiare. Në Shkup kemi mbi 90% të investimeve direkte të jashtme të cilat janë të koncentruara në qytetin kryesor. Ky koncentrim i zhvillimit të Shkupit ua ngushton frymën zhvillimit të rajoneve rajoneve të tjera. Qyteti rritet dhe alimentohet nga rrethina e drejtpërdrejtë dhe përmes këtij procesi Shkupi tjetërsohet nga rrethina tjetër e Maqedonisë e cila nuk arrin hapin e zhvillimit të Shkupit. Mendoj se është koha e fundit të eliminohet klima ideologjike e centralizimit ekonomik, administrativ dhe politik, por të inicohet dhe të zhvillohet një strategji e zhvillimit të barabartë rajonal. Politika e zhvillimit të barabartë rajonal përballet me sfida serioze edhe përkundër përpjekjeve për një avancim të zhvillimit të barabartë rajonal. Gjykuar në bazë të parametrave të zhvillimit të rajoneve jemi ende larg zhvillimit të barabartë ekonomik. Realizimi i programeve për zhvillim të barabartë ekonomik po tregohet jo efektiv dhe efikas. Rajonet përballen me papunësi më të madhe dhe në vitet e fundit nuk kanë përmirësim të dukshëm të PBB-së në krahasim me rajonet tjera të shtetit.

Struktura e PBB-së, RM = 100%

CENTRUM 24

	Rajoni i Vardarit	Rajoni Lindor	Rajoni Jugperëndimor	Rajoni Juglindor	Rajoni i Pellagonisë	Rajoni i Pollogut	Rajoni Verilindor	Rajoni i Shkupit
2000	6.1	7	9.6	7.4	14.3	7.9	5.6	42.1
2001	7	6	9	7	15	7	5	44
2002	7	7	9	7	15	8	5	43
2003	8	7	8	8	15	8	5	41
2004	7	7	9	8	14	8	5	43
2005	7	6	7	8	12	7	4	47
2006	8	7	8	7	12	7	4	47
2007	7	7	7	8	11	7	4	48
2008	7	8	9	7	12	8	5	44
2009	7	8	8	8	12	8	5	45
2010	7.1	8.7	8.2	9	12.1	7.7	4.7	42.5
2011	7.3	8.7	8.3	9.4	11.3	7.8	5.5	41.7
2012	7.8	8.3	8.1	9.4	10.9	7.3	5.5	42.8
2013	8.2	8.1	7.8	9.2	11.3	7.5	5.3	42.6
2014	8	8.2	7.9	10	11.1	7.1	5	42.8
2015	8	8	8.4	9.8	10.8	7	5.2	42.9
2016	7.8	7.9	8.2	10	10.9	7.1	5	43.1
2017	7.6	8.3	8.5	9.8	10.7	7.3	5	42.8
2018	7.7	8.2	8.3	9.4	11.2	7.2	4.9	43
2019	7.9	8.1	8.1	9.2	11.2	7.3	4.8	43.4
2020	7.9	8.1	8	9	11.1	7.4	4.7	43.7
2021	7.9	8.3	8.4	8.7	10.6	7.4	4.9	43.9

Për të arritur zhvillim të barabartë rajonal, është e nevojshme:

- Krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm përmes ndërtimit të infrastrukturës që lidh rajonet më të varfra me tregje më të mëdha, zona të zhvilluara.

- Mbështetja për bizneset lokale, ndihma për krijimin dhe mbështetje të bizneseve të vogla dhe të mesme në rajonet e varfra, për të siguruar rritjen e mundësive të punësimit dhe të zhvillimit ekonomik.

- Mbrojtja e diversitetit rajonal, zhvillimi i politikave që respektojnë dhe mbrojnë karakteristikat unike kulturore, sociale dhe ekonomike të rajoneve, duke i integruar ato në zhvillimin kombëtar.

- Politika fiskale e barabartë, të drejtuar për të mbështetur rajonet më të varfra, përmes transferimeve financiare dhe granteve për zhvillim ekonomik.

Lëvizjet migruese gjegjësisht shtegtimet ekonomike kurbetçare të shqiptarëve të Maqedonisë kanë qenë dhe janë të shumta, jo pse rajonet ku jetojnë shqiptarët janë rajone pasive ekonomike, por si rezultat i

krizës ekzistenciale. Nëse i analizojmë shkaktarët e këtyre shtegtimeve (migracioneve), mund të konstatojmë se lëvizjet e këtilla gjithmonë janë bërë dhe bëhen nga ndikimi i rrethanave ekonomike dhe i atyre historiko-politike.

Shtegtimet ekonomike kanë përfshirë pjesën e popullsisë së rritur dhe të aftë për punë të cilët në fillim i ka karakterizuar migrimi sezonal ose i përkohshëm (vetëm për një vit) në vendet e Evropës Perëndimore, kurse sot ai ka karakter tradicional dhe i trashëguar brez pas brezi. Migrimi ekonomik ka kuriozitet të posaçëm veçanërisht te njerëzit e rijë të cilët janë pa punë e të cilët nuk mund të punësohen dhe perspektivën e shohin jashtë vendit.

Nga të dhënat e disponueshme për emigrimin e regjistruar nga Republika e Maqedonisë, në periudhën 1952-1986, numri i personave të cilët kanë emigruar arrin në rreth 215.000 persona. Nga ana tjetër, Banka Botërore ka publikuar të dhëna se nga Republika e Maqedonisë deri në vitin 2010 kanë emigruar 447,000 mijë qytetarë. Kjo është 22% për qind e popullsisë së përgjithshme të Republikës. Si rezultat i lëvizjeve të emigrantëve, sot konsiderohet se mbi 650.000 janë emigrantë. (Realitete ekonomike 2005)

3. Ekonomia e Kosovës nga viti 1945 deri në ditët e sotme

Historia e zhvillimit ekonomik të Kosovës është e lidhur ngushtësisht me periudhat e ndryshme politike dhe shoqërore që ka kaluar ky rajon, duke filluar nga periudha pas Luftës së Dytë Botërore, periudha e përbashkët e Jugosllavisë, periudha e pasluftës dhe shpallja e pavarësisë. Nga viti 1945-1960 dallojmë proceset e para kurrë edhe fillon rindërtimi dhe aftësimi i kapaciteteve ekzistuese të industrisë bazë, që pati për qëllim intensifikimin e shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe vënien e bazës për fillimin e procesit të industrializimit të ekonomisë. Gjatë kësaj periudhe kemi një ritëm të ngadalshëm të zhvillimit ekonomik dhe me shfrytëzimin ekstensiv të faktorëve të prodhimit.

Është karakteristike se Kosova filloi të ndihmohej nga ndihmat ndërkombëtare dhe nga planifikimi qendror i Jugosllavisë për të ndihmuar në rritjen e prodhimit dhe kthimin e aftësisë punuese filluan investime në industrinë minerale (sidomos në Trepçë) dhe ndihmuan në zhvillimin e disa sektorëve të rëndësishëm si energjia dhe bujqësia (Krasniqi, 2018). Kjo periudhë ishte gjithashtu karakterizuar nga

ndihma dhe investimet e shtetit jugosllav, që ndihmuan në zhvillimin e sektorëve të rëndësishëm si energjia, ndërtimi dhe metalurgjia.

Në vitin 1981, shpërthimi i pakënaqësive dhe trazirave në Kosovë kishte një ndikim të thellë në ekonominë e rajonit, duke u bërë një shenjë e tensioneve të thella etnike dhe politike. Përprjekjet për autonomi dhe ndarjen e Kosovës nga Serbia shkaktuan një periudhë të pasigurisë politike dhe ekonomike, duke ulur ndjeshëm zhvillimin dhe duke krijuar barriera për zhvillimin e plotë ekonomik të rajonit.

Në këtë periudhë Kosova ishte ndër vendet më të varfura me një koeficient të zhvillueshmërisë dhe rang të zhvillueshmërisë më të ulët në ish-Jugosllavi nga viti 1953 e deri në vitin 1989. (Oda Ekonomike e Kosovës, 2001. Veçoritë strukturale të ekonomisë së Kosovës Fetah Reçica)

	Koeficienti i zhvillueshmërisë				Rangu i zhvillueshmërisë			
	1953	1971	1981	1989	1953	1971	1981	1989
RSFJ	100,0	100,0	100,0	100,0	-	-	-	-
Slovenia	151,6	144,3	138,8	162,2	1	1	1	1
Serbia	90,8	99,4	100,4	104,5	4	3	3	2
B e H	103,8	85,8	88,0	87,4	2	5	5	4
Mali i Zi	103,0	101,1	107,6	102,3	3	2	2	3
Maqedonia	78,0	92,1	94,0	86,4	5	4	4	5
Kosova	72,6	75,4	71,1	56,9	6	6	6	6


Në vitet 1990, pas shkatërrimit të Jugosllavisë, Kosova u bë pjesë e Serbisë dhe përjetoi një periudhë të errët të izolimit ekonomik dhe politik. Ndërhyrja serbe, masat represive dhe mbyllja e institucioneve lokale krijuan një klimë të pasigurt dhe të papërballueshme për zhvillimin e mundshëm. Industria e Kosovës u dëmtua, dhe të gjitha mundësitë për zhvillim u kufizuan. Lufta e Kosovës (1998-1999) e la rajonin me dëme të mëdha, duke shkatërruar një pjesë të madhe të infrastrukturës dhe industri, si dhe duke shkaktuar humbje të mëdha njerëzore dhe shpërngulje të popullsisë. Pas luftës, Kosova kaloi në një periudhë administrate ndërkombëtare nga Kombet e Bashkuara (OKB), dhe ekonomia ishte e varur nga ndihmat ndërkombëtare dhe rinovimi i buri-meve. Megjithatë, shumë probleme strukturore vazhduan të shfaqeshin. Kosova kishte një shkallë të lartë të papunësisë, ishte shumë e varur nga remitancat, dhe kishte shumë mangësi në sektorët kryesorë të bujqësisë dhe industrisë.

Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë dhe filloi të ndjekë një kurs të ri ekonomik. Shpallja e pavarësisë mundësoi krijimin e politikave ekonomike të pavarura, si dhe mundësinë për integrim në organizata ndërkombëtare dhe mundësi zhvillimi të reja për sektorët ekonomik.

Analiza pas pavarësisë Ekonomia e Kosovës në këtë periudhë ka pësuar një rritje të moderuar ekonomike të BPV, krahasuar me vendet e regionit.

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
BPV-ja Nominale	3 610 441	4 020 981	4 559 902	4 797 279	5 071 333	5 325 095	5 674 422	6 037 273	6 356 439	6 671 522	7 036 172	6 771 601	7 957 876	8 995 729	8 895 728
BPV-ja Reale	3 715 713	3 788 794	4 295 742	4 633 909	5 053 492	5 341 163	5 640 140	5 990 588	6 339 910	6 572 967	6 988 873	6 679 352	7 499 253	8 298 138	8 298 138
Rritja reale e BPV-së %	5,9	4,9	6,3	1,7	5,3	3,3	5,9	5,6	4,8	3,4	4,8	-5,3	19,7	4,28	4,07

Rritja reale e BPV-së vjetore krahasuar me vitin paraprak



(Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Kosova vazhdon të përballlet me sfida të mëdha, duke përfshirë papunësinë e lartë, mungesën e infrastrukturës, varësinë nga importet dhe vështirësitë në tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

4. Krahasimi i zhvillimit ekonomik (Shqipëri, Maqedoni, Kosovë)

Në krahasimin e zhvillimit ekonomik të këtyre shteteve pas Pavarësisë, mund të identifikohen disa aspekte të përbashkëta dhe dallime:

- Rritja ekonomike: Shqipëria dhe Maqedonia kanë pasur një rritje ekonomike më të qëndrueshme pas viteve 1990, ndërsa Kosova ka pasur një rritje më të shpejtë pas shpalljes së Pavarësisë, por është përballur me sfida të mëdha për të zhvilluar sektorët e rëndësishëm.

- Papunësia: Të tri shtetet kanë përjetuar nivele të larta të papunësisë, por Shqipëria dhe Maqedonia kanë pasur një rritje më të madhe të mundësive të punësimit në periudhën pas 2000.

- Investimet e huaja dhe privatizimi: Shqipëria ka pasur një periudhë më të gjatë të privatizimit dhe tërheqjes së investimeve, ndërsa Kosova dhe Maqedonia kanë pasur periudha më të ngadalta të zhvillimit të këtyre fushave.

- Korrupsioni dhe instabiliteti politik: Të tri shtetet janë përballur me sfida të ngjashme në luftën kundër korrupsionit dhe instabilitetit politik që ka ndikuar në zhvillimin e ekonomisë.

112 vjet pas Pavarësisë së Shqipërisë, zhvillimi ekonomik i shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut tregon një histori të ndërlikuar, ku faktorët historikë, politikë dhe ekonomikë kanë pasur ndikim të thellë. Çdo shtet ka pasur një rrugë të veçantë zhvillimi, por të gjithë janë përballur me sfida të ngjashme: tranzicioni nga ekonomitë e centralizuara në ato të tregut, investimet e huaja dhe përpjekjet për të siguruar stabilitetin ekonomik. Përmirësimi i mëtejshëm i kushteve ekonomike dhe krijimi i mundësive për zhvillim të qëndrueshëm do të kërkojnë një angazhim të vazhdueshëm nga qeveritë, për të trajtuar problemet strukturore dhe për të siguruar përparimin e vazhdueshëm.

Literatura

1. *Akademia, e Shkencave e Shqipërisë (2007). Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi III, Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912-7 prill 1939. Tiranë, Shqipëri: Botime Toena. fq. pp. ISBN 978-99943-1-269-6.*
2. <https://euronews.al/ekonomia-ne-shqiperi-gjate-komunizmit-teresisht-e-varur-nga-ndihmat-e-huaja/>
3. Komisioni Evropian. (2022). *Shqipëria dhe Rritja Ekonomike Pas 2015*. Raporti i Komisionit Evropian.
4. INSTAT Diaspora e Shqipërisë në Shifra fq 8
5. Banka Qendrore e Shqipërisë. (2021). *Raporti për Stabilitetin Ekonomik dhe Financiar në Shqipëri*. Banka Qendrore e Shqipërisë.
6. financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Treguesit-Kryesorë-Makroekonomik-2023
7. Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT). (2022). *Statistika Ekonomike për Shqipërinë*.
8. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). (2023). *Shqipëria dhe Rritja Ekonomike: Analizë dhe Perspektiva*. Komisioni Europian.
9. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). (2017). *Kriza dhe Stabilizimi Ekonomik në Maqedoni: Një Analizë e Rritjes Pas 2008*. FMN.
10. (Realitete ekonomike 2005) Izet Zeqiri, Realitete Ekonomike Albës, Tetovë, f.45
11. Strategjia za Republika Makedonija 2010-2013) dokument na evropskata banka za obnova i razvoj f 7.
12. Izet Zeqiri. Realitete ekonomike 2005, f 11.
13. Krasniqi, N. (2018). *Historia Ekonomike e Kosovës dhe Dajti - Analizë e Gjatë e Rindërtimit*. Prishtinë: Botimet UET.

14. Gashi, F., & Hasani, H. (2017). *Kosova dhe Ekonomia e Pasluftës: Kriteret dhe Strategjitë e Zhvillimit*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

15. Hoxha, L. (2013). *Kosova në Përpjekje për Rindërtim Ekonomik pas Luftës*. Tiranë: Shtypshkronja Dituria.